



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:255311
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05550981

C.nr.761/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësve H.B, nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, Ç.M-G, nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit V.M, nga Rahoveci, A.M, nga fshati Nushpall, Komuna e Rahovecit dhe A.B nga fshati Pataqan i Epërm, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i tyre i autorizuar avokati F.S nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokat B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 10,516.50 euro, jashtë seancës, me datë 05.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve H.B, nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, Ç.M-G, nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, V.M, nga Rahoveci, A.M, nga fshati Nushpall, Komuna e Rahovecit dhe A.B nga fshati Pataqan i Epërm, Komuna e Rahovecit.
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses H.B, nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 05.12.2019, e deri me datën 31.01.2023, për 27 % të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 38 muaj, t’ia paguaj shumën prej 2,103.30 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 05.12.2022 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Ç.M-G, nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 05.12.2019, e deri me datën 31.01.2023, për 27 % të pagës bazë (393.00 euro) x 27% (minusuar 54.45 euro në listën e pagave nga shuma 106.11 euro) = 51.66 euro x 38 muaj, t’ia paguaj shumën prej 1,963.08 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 05.12.2022 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.

- IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses V.M, nga Rahoveci, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 05.12.2019, e deri me datën 31.01.2023, për 27 % të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 38 muaj, t'ia paguaj shumën prej 2,103.30 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 05.12.2022 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- V. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.M, nga fshati Nushpall, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 05.12.2019, e deri me datën 31.01.2023, për 27 % të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 38 muaj, t'ia paguaj shumën prej 2,103.30 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 05.12.2022 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- VI. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.B nga fshati Pataqan i Epërm, Komuna e Rahovecit, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 05.12.2019, e deri me datën 31.01.2023, për 27 % të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 38 muaj, t'ia paguaj shumën prej 2,103.30 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 05.12.2022 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- VII. REFUZOHET SI E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditëses së dytë Ç.M-G, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 1,963.08 euro e deri në shumën prej 2,103.30 euro dhe atë për shumën prej 140,22 euro.
- VIII. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësve H.B, Ç.M-G, V.M, A.M, dhe A.B, t'i paguajë shumën prej 725,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.
- IX. Refuzohet kërkesa për kompensimin e shpenzimeve procedurale mbi shumën e aprovuar si në pikën VIII të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësit H.B, nga fshati Drenoc, Komuna e Rahovecit, Ç.M-G, nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit V.M, nga Rahoveci, A.M, nga fshati Nushpall, Komuna e Rahovecit dhe A.B nga

fshati Pataqan i Epërm, Komuna e Rahovecit, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datën 05.12.2022, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 10,516.50 euro.

Të njëjtit sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura në SH.F.M.U. “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve me parashtrësë të veçantë prej datës 18.03.2024, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, paditësve me vendimin e nr.01/33 të datës 29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datën 06.02.2023, ju takon e drejta në kompensimit për periudhën nga data 05.12.2019, e deri me datën 31.01.2023, ku në bazë të kësaj paditësve i takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit 27% të ardhurave në pagë të mësimdhënësve dhe atë mësimdhënës me diplomë fakulteti. Andaj i kanë propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 13.03.2023, ku ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit si dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për pagesën e këtyre mjeteve pasi që Ministria e Arsimit si palë nënshkruese e kësaj kontrate, nuk ka ndarë mjetet financiare të nevojshme për Komunën e Rahovecit. Paditësi ka kërkuar kompensimin e pagave për 27% të vlerës së pagës bazë, lidhur me këtë e paditura konsideron se kjo kërkesë është e pabazë, për shkak se dispozita e nenit 7 të KKAK-së nuk ka përcaktuar se duhet të kompensohet dhe nëse duhet të kompensohet nga punëdhënësi i fundit apo se kush duhet të paguajë kompensimit në bazë të kualifikimit. Paditësi nuk i ka shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/8 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses Hava Krasniqi; diplomën Nr. 1007 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prizren, e paditëses Hava Krasniqi; licenca e mësimdhënësit nr.100022764; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/73 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses Ç.M- G; diplomën Nr. 1061 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditëses Ç.M- G; licenca e mësimdhënësit nr.1026109; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/88 e datës 08.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses V.M; diplomën Nr. 917 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditëses V.M; licenca e mësimdhënësit nr.1026582; kontratën e punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/2 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.M; diplomën Nr. 334 e lëshuar nga

Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditësit A.M; licenca e mësimdhënësit nr.100008693; kontratën e punës për mësimdhënës e datës 01.06.2016, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A B a; diplomën Nr. 332 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditësit A.B; licenca e mësimdhënësit nr.100008706; si dhe listat e pagës.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësit kanë të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësit posedojnë licencë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësve kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe licencimit, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/8 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses H K, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm.

Me administrimin e diplomës Nr. 1007 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Prizren, e paditëses Hava Krasniqi, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.K ka përfunduar studimet më 23.11.2013 dhe mori titullin Bachelor i Programit Matematikë - Informatikë.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100022764, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.K është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/73 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses Ç.M - G, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm.

Me administrimin e diplomës Nr. 1061 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditëses Ç M - G, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Ç M - G ka përfunduar studimet më 03.03.2015 dhe mori titullin Bachelor i Programit Parashkollor.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 11026109, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Ç M - G është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/88 e datës 08.09.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses V.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta

është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm.

Me administrimin e diplomës Nr. 917 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditëses V.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësja V.M ka përfunduar studimet më 25.11.2014 dhe mori titullin Bachelor i Programit Fillor.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 1026582, gjykata vërtetoi faktin se paditësja V.M është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me nr. protokollit: 01/2 e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SH.F.M.U. “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm.

Me administrimin e diplomës Nr. 334 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditësit A.M, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.M ka përfunduar studimet më 25.05.2012 dhe mori titullin Bachelor i Programit Fillor.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100008693, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.M është e licencuar nga MASHT-i”.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës e datës 01.06.2016, e lidhur ndërmjet Komunes së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit A.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti është i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës si Drejtor në SH.F.M.U. “Sakip Bellaqa” në fshatin Pataqan i Epërm.

Me administrimin e diplomës Nr. 332 e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit, Qendra në Gjakovë, e paditësit A.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.B ka përfunduar studimet më 18.02.2014 dhe mori titullin Bachelor i Programit Fillor.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100008706, gjykata vërtetoi faktin se paditësi A.B është e licencuar nga MASHT-i”.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1 të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4 të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej*

35%”. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësve t’i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parashihet “*Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune*” dhe paragrafi 4 “*Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA*”. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Gjykata vendosi ta refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë paditëses së dytë Ç.M-G, për pjesën tjetër të padisë mbi shumën prej 1,963.08 euro e deri në shumën prej 2,103.30 euro dhe atë për shumën prej 140,22 euro, pasi që gjykata vlerëson se në rastin konkret bazuar në Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008 në pikën 4 nën-pikën 3 të vendimit përcaktohet se “*Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%*”, në këtë drejtim paditësja në kërkesëpadi ka kërkuar që të kompensohet për 27% të pagës mujore (421.00 euro), ndërsa në bazë të listës së pagës paditësja ka pasur pagën bazë 393,00 €uro, ndërsa bazuar në pikën 4 të Vendimit të Qeverisë, paditësit përfitojnë ngritje në bazë të pagës bazë dhe jo në bazë të pagës mujore siç pretendojnë paditësit.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.*”. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e saj e aprovoi në tërësi pasi që është e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: “*Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën*

proporcionale të shpenzimeve”, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqfituese, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën VIII të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 725,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 624,00 euro si dhe për taksën gjyqësore 101,00 euro.

Gjykata ka vendosur si në pikën IX të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se shpenzimet tjera për përpilimin e parashtresave të kërkuara nuk hyjnë në shpenzimet e shkaktuara gjatë procedurës gjyqësore konform nenit 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.761/2022, më datë 05.04.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.